VENDIM
Nr. 995, datë 8.11.2013

PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2013, MIRATUAR PËR MINISTRINË E MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË, PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE FAMILJES SË TË NDJERIT LIRAK BEJKO, ISH-I DËNUAR POLITIK, I VETËFLIJUAR GJATË GREVËS SË URISË NË NËNTOR 2012

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 13 të ligjit nr. 119/2012 "Për buxhetin e vitit 2013", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe të ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, në buxhetin e vitit 2013, t'i shtohet fondi prej 500 000 (pesëqind mijë) lekësh, për dhënien e ndihmës financiare familjes së të ndjerit Lirak Bejko, ish-i dënuar politik, i vetëflijuar gjatë grevës së urisë në nëntor 2012.
2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama